



VROJTIMI I AKTIVITETIT KREDITUES

2

0

1

8

Tremujori i tretë

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

HYRJJE¹

Pyetësoni synon të tërheqë opinionin e bankave tregtare lidhur me zhvillimet e tre muajve më të fundit në ofertën dhe kërkesën për kredi, si edhe pritjet e tyre për tremujorin e ardhshëm. Vrojtimi i aktivitetit kreditues jep në mënyrë të përmbledhur perceptimet e bankave mbi ndryshimet në kushtet e ofertës për kredi, ilustruar nëpërmjet standardeve dhe kushteve e termave të kreditimit, si edhe mbi ndryshimet në kërkesën për kredi, si për bizneset ashtu edhe individët. Kjo analizë bazohet në rezultatet e agreguara nga përgjigjet e njëmbëdhjetë bankave, të cilat zotërojnë peshën më të madhe të stokut të kredisë së dhënë për sektorin privat.

¹ Pyetësoni i vrojtimit të aktivitetit kreditues është rishikuar në tremujorin e dytë të vitit 2018, me qëllim përafrimin e tij të mëtejshëm me praktikën më të fundit ndërkombëtare, sidomos me atë të Bankës Qendrore Evropiane. Për pasojë, dhe analiza e lidhur me të është përshtatur me pyetësonin e ri. Analiza është pasuruar në terma të pyetjeve shtesë si edhe specifikimeve lidhur me faktorët që ndikojnë standardet, kushtet e kreditimit dhe kërkesën për kredi. Pyetësonin e vrojtimit të aktivitetit kreditues së bashku me fjalorin e termave të përdorur në të, një material të shkurtër mbi rëndësinë e këtij vrojtimi dhe disa aspekte metodologjike, i gjeni të publikuara në adresën https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues.

PËRMBLEDHJE

Bazuar në perceptimet e bankave tregtare, standardet e kreditimit për bizneset mbetën thuajse të pandryshuara në tremujorin e tretë të vitit 2018, pavarësisht një përqaasjeje më të kujdesshme ndaj bizneseve të vogla e të mesme. Nga ana tjetër, kërkesa për kredi e bizneseve ishte më e ulët sipas vlerësimeve të bankave. Standardet e kreditimit u raportuan të lehtësuara për individët, si për kreditë konsumatore ashtu edhe për ato me qëllim blerje banese. Në të njëjtën linjë shfaqet edhe kërkesa për kredi e individëve, e cila u raportua më e lartë në tremujorin e tretë, për të dyja kategoritë.

Në tremujorin e fundit të vitit 2018, bankat presin të aplikojnë standarde të ngjashme me tremujorin e tretë mbi kreditë e destinuar për bizneset, ndërkohë që për individët synojnë t'i lehtësojnë ato më tej. Kërkesa për kredi, sipas gjykimit të bankave, pritet të jetë më e lartë nga tremujori i tretë, si në kategorinë e bizneseve ashtu edhe në atë të individëve.

STANDARDET, TERMAT E KREDITIMIT DHE KËRKESA PËR KREDI


1. KREDIA PËR BIZNESE

1.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit në tremujorin e tretë të vitit, për kategorinë e bizneseve, u raportuan thuajse të pandryshuara. Megjithatë, në ndarjen sipas madhësisë së biznesit, ato rezultuan të shtrënguara për kreditë dhënë bizneseve të vogla dhe të mesme². Standardet e kreditimit u raportuan thuajse të pandryshuara, si për kreditë me qëllim investimi, ashtu edhe për ato për likuiditete.

Bankat u shprehën se presin t'i mbajnë të pandryshuara standardet e kreditimit për bizneset në tremujorin e fundit të vitit, si në terma të madhësisë së tyre, ashtu edhe në terma të qëllimit të përdorimit të kredisë.

Grafik 1. Standardet e kreditimit për bizneset dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm¹



¹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të standardeve.


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktorët që ndikuan në kahun shtrëngues të standardeve të kreditimit për bizneset në tremujorin e tretë ishin të lidhura me kostot dhe kufizimet nga bilanci (kryesisht të lidhura me kostot dhe kufizimet nga pozicioni kapital i bankës), me aftësinë paguese të kredimarrësit, si edhe me situatën aktuale

² Kryesisht në sajë të politikës së ndjekur nga një bankë e sistemit.

ekonomike dhe perspektivën e saj. Në kahun lehtësues të standardeve veproi trysnia nga konkurrenca në sistemin bankar.

Grafik 2. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e bizneseve²




²: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e standardeve. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësorin e rishikuar në qershor 2018.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Tabloja e kushteve dhe e termave të përgjithshme mbi kreditë e reja të miratuara gjatë tremujorit të tretë të vitit mbeti e pandryshuar, kryesisht në reflektim të marzheve të pandryshuara të aplikuara mbi kreditë normale, si edhe komisioneve të njëjta me një tremujor më parë. Nga ana tjetër, marzhet më të larta për kreditë me rrezik, si edhe kushtet e tjera joçmim, të tilla si kërkesa më e lartë për kolateral, vepruan në kahun shtrëngues të kushteve dhe termave të përgjithshme të kreditimit për bizneset.


Grafik 3. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshme në miratimin e kredive të reja për bizneset³



³: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuara, ndërsa ato negative të shtrënguara. Burimi: Banka e Shqipërisë. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësorin e rishikuar në qershor 2018.

Në kahun lehtësues të kushteve dhe termave të kreditimit u raportua trysnia nga konkurrenca. Ndërkohë, në kahun e kundërt ndikuan toleranca e bankës ndaj rrezikut, si edhe perceptimi i rrezikut³.

Grafik 4. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e bizneseve⁴




⁴: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e kushteve dhe termave. *: Ky grafik bazohet mbi një pyetje të re të shtuar në pyetësin e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.3. Kërkesa për kredi

Kërkesa për kredi u raportua më e ulët nga një tremujor më parë, si ajo e bizneseve të vogla dhe të mesme, ashtu edhe kërkesa e bizneseve të mëdha. Edhe në prizmin e qëllimit të përdorimit të kredisë, kërkesa rezultoi më e ulët, si për kreditë për investime, ashtu dhe për likuiditete.

Grafik 5. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për bizneset⁵



⁵: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në tremujorin e fundit të vitit, bankat presin kërkesë të gjallëruar në të gjitha kategoritë e biznesit. Kërkesa më e lartë nga ana e bizneseve në tremujorin e katërt të vitit 2018, pritet të shfaqet si për kredinë me qëllim investimi, ashtu edhe për atë me natyrë likuiditeti.

Faktorët e perceptuar nga ana e bankave si përcaktues të kërkesës më të ulët për kredi ishin: nevoja më e ulët për financimin e investimeve fikse, si edhe inventarëve e kapitalit qarkullues; financimi me burimet e brendshme të vetë biznesit; besimi i biznesit; si dhe situata ekonomike dhe perspektiva e

³ Pyetjet e lidhura me faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e kushteve dhe termave të kredisë i janë shtuar pyetësorit të VAK për herë të parë në qershor 2018.

saj. Niveli i përgjithshëm i normave të interesit, si edhe nevojat për rifinancimin e borxhit ishin dy faktorët e perceptuar si nxitës të kërkesës për kredi nga ana e bizneseve.

Grafik 6. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për bizneset⁶



⁶: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënieën e saj. *: Tregues i ri i situatës në pyetësorin e rishikuar në qershor 2018.


Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË

2.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit për individët vijuan të raportohen të lehtësuara edhe në tremujorin e tretë të vitit. Ky lehtësim u manifestua në të dyja kategoritë, si për kreditë për blerje banese, ashtu edhe për kreditë konsumatore. Bankat u shprehën për një lehtësim të mëtejshëm të pritur të standardeve të kreditimit për individët, për të dyja kategoritë, në tremujorin e fundit të vitit.

Grafik 7. Standardet e kreditimit për individët dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm⁷




⁷: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të standardeve.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktorët që diktuan standarde të lehtësuara për individët në tremujorin e tretë ishin: toleranca më e lartë e bankave ndaj rrezikut; perceptimi më i ulët i rrezikut lidhur me aftësinë paguese të kredimarrësit; si dhe kosto më të ulëta nga pozicioni i kapitalit të bankave.

Grafik 8. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e individëve⁸




⁸: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se ai faktor ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e standardeve. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshme për kreditë akorduar individëve u lehtësuan në tremujorin e tretë. Përmirësimi i kushteve dhe termave të përgjithshme në kreditë dhënë individëve u mundësua nëpërmjet një kërkese më të ulët për kolateral në raport me kredinë e marrë. Në kahun e kundërt me këtë faktor ndikuan marzhet më të larta të aplikuara mbi kreditë me rrezik, si dhe madhësia e kredisë.

Grafik 9. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshme në miratimin e kredive të reja për individët⁹




⁹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe termat e lehtësuara, ndërsa ato negative të shtrënguara.

*: Tregues i ri i shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktori që përcaktoi përmirësim të kushteve dhe termave të kreditimit për individët ishte i lidhur me trysinë nga konkurrenca. Nga ana tjetër, faktorët e tjerë, si kostot dhe kufizimet nga bilanci dhe toleranca e bankës ndaj rrezikut, u raportuan pothuajse të pandryshuar nga një tremujor më parë.

Grafik 10. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e individëve¹⁰




¹⁰: Vlerat pozitive tregojnë se ai faktor ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e kushteve dhe termave. *: Ky grafik bazohet mbi një pyetje të re të shtuar në pyetësorin e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3. Kërkesa për kredi

Kërkesa e individëve për kredi ishte më e lartë në tremujorin e tretë të vitit, e nxitur si nga kredia me qëllim blerje banese, ashtu edhe nga ajo konsumatore. Vlerësimet e bankave për tremujorin e katërt të vitit tregojnë një rritje të mëtijshme të kërkesës për kredi nga ana e individëve, në të dyja kategoritë.

Grafik 11. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për individët¹¹




¹¹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bazuar në perceptimet e bankave tregtare, kërkesa për kredi nga ana e individëve u nxit nga: nevoja e shtuar për financimin e konsumit dhe blerjes së banesave; zhvillimet aktuale dhe të pritura në tregun e banesave; kreditë nga bankat dhe jobankat; si dhe niveli i përgjithshëm i normave të interesit. I vetmi

faktor me ndikim në kahun rënës në kërkesën për kredi të individëve, sipas gjykimit të bankave, ishte përdorimi i burimeve të brendshme të financimit.

Grafik 12. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për individët¹²



¹²: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënien e saj. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.